

## 1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2014

**Tabelë 1:** Veprimet e përkohshme në tregun e hapur  
(në milionë lekë\*)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore
03.04.2014		15,750.00	3,000.00
10.04.2014		6,900.00	2,000.00
17.04.2014		15,500.00	2,000.00
18.04.2014	1,500.00		
21.04.2014	1,500.00		
22.04.2014	8,000.00		
23.04.2014	250.00		
24.04.2014		20,420.00	2,000.00
02.05.2014		8,500.00	2,000.00
08.05.2014		10,000.00	2,000.00
15.05.2014		9,200.00	2,000.00
22.05.2014		11,500.00	2,000.00
29.05.2014		20,000.00	2,000.00
05.06.2014		13,670.00	2,000.00
12.06.2014		16,500.00	2,000.00
19.06.2014		18,340.00	2,000.00
26.06.2014		19,500.00	2,000.00

### 1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2014, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të likuiditetit dhe operacione të përhershme, me qëllim strukturimin e portofolit të BSH-së.

**Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 20.61 miliardë lekë, kundrejt 21.22 miliardë lekëve në tremujorin e parë të vitit 2014. Likuiditeti mesatar i injektuar rezulton rreth 9.6% më i lartë se 1 vit më parë, kur kjo vlerë ishte rreth 18.8 mld lekë.**

Gjatë tremujorit të dytë, likuiditeti në sistem bankar u ndikua negativisht nga efekti i cash-it (-3.27 mld lekë), dhe pozitivisht për 4.7 mld lekë nga efekti i buxhetit.

Për injektimin e likuiditetit të përkohshëm, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 14.29 miliardë lekë në javë\*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë

riblerjeje me maturim njëmuor, mesatarisht 2.07 miliardë lekë në javë\*. Ndërkohë, injektimet njëditore në datat 18-23 Prill 2014, kanë synuar plotësimin e mungesës së krijuar në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës.

Edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit është vijuar me operacionet për shitblerje me të drejta të plota, duke synuar uljen e zotërimit të BSH-së në bono thesari jo me shumë se niveli 70% i totalit të çdo emetimi. Duke qenë se portofoli i BSH-së, gjatë tremujorit të parë të vitit, ishte rritur me 100 milionë lekë kundrejt nivelit të fundvitit 2013, në tremujorin e dytë është zhvilluar një ankand për blerje bono thesari 12-mujore të sapoemtuara me shumë të shpallur 300 milionë lekë, shoqëruar me ulje të riinvestimit në bono thesari 6-mujore për 200 milionë lekë. Ndërhyrja në blerje u realizua vetëm për 150 milionë lekë. Për rrjedhojë, gjatë tremujorit të dytë të vitit, rritja e portofolit të BSH-së u korrigjua me 50 milionë lekë.

\* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.


## 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Depozita njëditore është përdorur në 6 raste, mesatarisht për 0.11 miliard lekë, me të njëjtën frekuencë përdorimi të regjistruar në tremujorin e kaluar kur mesatarja ka qenë 0.12 miliard lekë.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 6 raste, mesatarisht 0.45 miliard lekë. Gjatë tremujorit të dytë të vitit, ky instrument u përdor në 6 raste, mesatarisht 0.63 miliard lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2014.

Grafik 1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2011-2014 (me çmim blerjeje)




## 2. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2014

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2014, Banka e Shqipërisë ka vijuar të mos ndërhyjë në tregun valutor.

Grafik 2. Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e dytë të vitit 2014



## 2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të dytë kanë vijuar të lidhen kontratat *swap* në valutë dhe lekë, midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nxitur nga nevoja e menaxhimit të likuiditeteve të Ministrisë së Financave. Në fillim të tremujorit, kontratat *swap* të pamaturuara ishin 15 milionë euro dhe gjatë periudhës 8 maj – 16 qershor u lidh dhe një kontratë *swap* për 23 milionë SDR kundrejt lekë, por deri në mes të muajit qershor, të gjitha këto kontrata u maturuan. Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Financave i ka shitur Bankës së Shqipërisë 22 milionë SDR dhe ka blerë nga ajo 2 milionë euro, në mënyrë të përhershme. Blerjet e valutës së Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave qenë në nivelin 9,970.68 milionë lekë, ndërsa shitjet 6,832.26 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 285.89 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCIVE	9,970.68	6,832.26
TË TJERA (IDA, IBRD)	285.89	